



THE SCHOOL DISTRICT OF  
PHILADELPHIA

Viti Shkollor 2020-2021:

# Grafikimi i një Rruge Përpara ... Së bashku.

QERSHOR 2020



ORGANIZATAT KONTRIBUESE:

  
**accenture**

# Për Komunitetin e Drejtorisë Arsimore të të Filadelfias:

Këto kanë qenë kohë të vështira. Ndikimi i COVID-19 dhe ndikimi i vazhdueshëm i racizmit të institucionalizuar janë dy nga krizat më të vështira të cilat po përballemi si individë, si një bashkësi shkollore dhe si qytet. Mënyra më e mirë për të punuar përmes një krize është *së bashku ...dhe së bashku* është se si do të ecim përpara.

Duke parë përpara vitin e ardhshëm shkollor, duhet të marrim disa vendime të rëndësishme se si do të duket shkolla dhe si do të përjetojnë nxënësit tanë të mësuarit. Ne po i afrohem kësaj pune në mënyrë të menduar, bashkëpunuese dhe me një ndjenjë të madhe përgjegjësie. Ne do të drejtohem nga një grup parimesh thelbësore që pasqyrojnë përparësitë tona më të larta: shëndetin dhe sigurinë e studentëve dhe të punësuarve tanë, ofrimin e vazhdueshëm të përvojave arsimore me cilësi të lartë për të gjithë studentët dhe angazhimin e komunitetit tonë të Drejtorisë Arsimore. Mendimi juaj është thelbësor. Ne jemi duke krijuar mundësi në gjithë procesin për prindërit, familjet, studentët, të punësuarit, si dhe anëtarë të tjerë të komuniteteve tona shkollore për të ndihmuar të informojmë një plan përfundimtar që mban sigurinë dhe interesat e përbashkëta të gjithë komunitetit tonë në mendje.

Ne po i bëjmë të gjitha këto në kontekstin e një të ardhmeje shumë të pasigurt. Progresi i testimit dhe zhvillimit të vaksinave, evolucioni i koronavirusit, kërkesat rreth mbajtjes së maskave, distancës fizike, dhe rregullat nga qeveritë federale, shtetërore dhe lokale janë gjithnjë në ndryshim. Kjo do të thotë që ne duhet të jemi të shkathët në aftësinë tonë për të planifikuar dhe për t'u përshtatur me ato rrethana që ndryshojnë. Ne jemi të përkushtuar të bëjmë vetëm atë.


Planifikimi ynë fillestar përfshin tre skenarë - *të mësuarit në person, të mësuarit dixhital dhe një model të të mësuarit hibrid*. Ne jemi në kontakt të përditshëm me ekspertë të shëndetit publik dhe drejtues të tjerë nga i gjithë qyteti dhe vendi që po ndajnë praktikatat më të mira dhe po zgjerojnë mendimin tonë pasi marrim parasysh shumë kompleksitete si, operacionet e përditshme të shkollës, akademikët, protokollet e sigurisë shkollore, transporti i studentëve, shërbimi i vaktit të ushqimit, rregullat e punonjësve dhe shumë të tjera do të duhet të ndryshojnë për të promovuar mjedise të sigurta dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë. Kjo përfshin mbështetjen e nevojave shumë reale sociale-emocionale që studentët dhe punonjësit tanë do të kenë si rezultat i kësaj pandemie dhe adresimin e të gjitha formave të pabarazisë në të gjithë Drejtorinë tonë.

Ende ka shumë punë për të bërë. **Qëllimi ynë është të ndajmë një plan përfundimtar në muajin Korrik në mënyrë që Drejtorja jonë dhe familjet tona të mund të përgatiten për një vit shkollor të suksesshëm dhe të sigurt.**

Ne do t'ju mbajmë të informuar për mendimin tonë gjatë kësaj rruge. Ju inkurajoj gjithashtu të vizitoni [www.philasd.org/2020schoolstart](http://www.philasd.org/2020schoolstart) për informacionin më të fundit në lidhje me këtë punë të rëndësishme.

Faleminderit.

William R. Hite, Jr., Ed.D.  
Superintendent




## Tabela e përmbajtjes:

FAQE	
4	Qëllimi ynë kryesor dhe parimet udhëzuese
5	Qasja dhe organizimi
6	Mendime dhe angazhimi
7	Shëndetësia dhe Siguria
9	Modelet dhe Operacionet e Mësimit
14	Konsideratat e fuqisë punëtore
16	Afati kohor



# Qëllimi ynë kryesor dhe parimet udhëzuese:

Drejtorja Arsimore e Filadelfias është duke punuar për të siguruar që rifillimi i shkollës të jetë i sigurt duke përfshirë familjet dhe punonjësit tanë dhe të përcaktojë përparësi në arritjet e studentëve, në udhëzimet me cilësi të lartë, në shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve. Në të gjithë këtë punë procesi ynë i planifikimit dhe i vendimit po ndihmohet nga parimet udhëzuese më poshtë.



**Shëndeti dhe Siguria**→ Drejtorja Arsimore do të bëjë gjithçka që është e mundur për të mbrojtur shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e studentëve, punonjësve dhe të gjithë komunitetit. Planifikimi dhe marrja e vendimeve do të udhëhiqet nga Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC), Departamenti i Arsimit i PA, dhe Drejtorja e Shëndetit Publik të Filadelfias, udhëzime të mjekut, mjekë dhe ekspertë të shëndetit publik nga Spitali i Fëmijëve në Filadelfia.

**Udhëzime të vazhdueshme me cilësi të lartë**→ Drejtorja do të japë udhëzime me cilësi të lartë për të gjithë studentët nëpër mjedise me njerëz dhe mjedise dixhitale, për të mbështetur arritjet e studentëve.

**Edukim i barabartë** → Drejtorja do t'u sigurojë të gjithë studentëve të drejtën në udhëzime cilësore dhe mbështetje emocionale sociale, me fokus në heqjen dhe përfundimin e praktikave raciste.

**Vendimmarrja e drejtuar nga të dhënat**→ Drejtorja do të përdorë të dhëna dhe analiza të ekspertëve për të informuar vendimmarrjen dhe ndërtimin e besimit të të gjitha palëve të interesuara. Vendimet tona do të informohen nga studentët, punonjësit dhe anëtarët e komunitetit të shkollës.


**Përshtatshmëria**→ Me paqartësinë dhe peizazhin në ndryshim, plani i Drejtorisë do të ndërtojë fleksibilitet, kështu që ne jemi të përgatitur të përshtatemi bazuar në nevojat e palëve të interesuara dhe ndryshimet e nevojshme nga rrethanat mjekësore dhe udhëzimet e shëndetit publik.

**Komunikim i saktë dhe në kohë**→ Drejtorja do të sigurojë që studentët, punonjësit dhe familjarët të kenë informacionin e nevojshëm për të qenë të sigurt dhe të mbajnë të azhurnuar të gjithë palët e interesuara me informacione të rëndësishme gjatë gjithë vitit shkollor.



# Qasja dhe organizimi:

Ndërsa shkolla fillon në vjeshtë, është thelbësore që të bëjmë gjithçka që është e mundur për të siguruar shëndetin dhe sigurinë e të gjithë anëtarëve të komunitetit të shkollës, të përpiqemi të sigurojmë përvojën më të mirë akademike për studentët dhe të marrim parasysh nevojat e familjeve dhe palëve të interesuara. Është përmes këtyre tre drejtimeve që ne po i afrohem punës tonë dhe po shqyrtojmë opsionet për vitin shkollor 2020-2021.



Proçesi i planifikimit të Drejtorisë është i strukturuar rreth shtatë grupe pune që po shqyrtojnë të gjitha aspektet e rifillimit të shkollave për të parë opsionet e disponueshme, për të përcaktuar dhe për të identifikuar varësitë e kërkuara.

## Grupet e Punës

**Shëndeti dhe Siguria** — Protokollat që përfshijnë distancimin social, testimi i pajisjet mbrojtëse edhe kontrolle, ndjekjen dhe raportimin, dhe trajnimin

**Akademik** — Programet mësimore, praktikat mësimore, dhe integrimi në teknologji

**Rregullat e Punonjësve dhe Mbështetja** — Rregullat, trajnimi, mbështetja, dhe nevojat e personelit për modele mësimore dhe shëndeti i punonjësve

**Komunikimi** — Praktikrat për të mbajtur studentët, familjet, dhe personelin të informuar dhe të angazhuar

**Ndërtesat** — Orari i pastrimeve edhe praktikimeve, protokollat e zonave për përmirësimin e ndërimit bazuar në udhëzimet e shëndetit publik

**Shërbimi i Transportit dhe Ushqimit** — Programi i shërbimeve dhe praktikrat e pastrimit bazuar në modelet mësimore

**Funksionimi i Shkollave dhe Mbështetja** — Kalendari akademik, oraret e shkollës, dhe mbështetja sociale-emocionale

## Vartësitë

- Të dhënat shëndetësore
- Financimi i fondeve
- Fuqia punëtore
- Udhëzimi i Agjencisë

## Mendime dhe angazhimi:

Reagimi nga palët e interesit tonë është një pjesë thelbësore e planifikimit tonë dhe do të bëhet në tre mënyra.

Një anketim në internet do të nisë në Qershor për të na ndihmuar të kuptojmë më mirë se çfarë funksionoi mirë me mësimin dixhital këtë vit, çfarë duhet të përmirësohet, dhe cilat kushte, praktika dhe protokolle janë më të rëndësishme për ju pasi konsiderojmë një kthim të sigurt në ndërtesat e shkollës sonë. Anketimi pasqyron gamën e opsioneve fillestare që ne jemi duke eksploruar, të cilat janë përfshirë në pjesët që do të pasojnë. Përshtypjet tuaja do të na ndihmojnë të përcaktojmë përparësitë e këtyre opsioneve. Ne gjithashtu do të presim dhe nga mbledhjet virtuale për të marrë reagime shtesë nga komuniteti përpara se planet tona të përfundojnë, si dhe të krijojmë mundësi që palët e interesuara të ndajnë informacione dhe reagime përmes postës elektronike dhe telefonit.





# Shëndetësia dhe Siguria:

Ndërtesat e shkollës duhet të jenë vende të sigurt për të mësuar dhe zyrat duhet të jenë vende të sigurt për të punuar. Me shëndetin dhe sigurinë më së shumti në mendje, ne jemi të përkushtuar për zhvillimin e një procesi të rifillimit të sigurt dhe domethënës i cili përputhet plotësisht me udhëzimet e dhëna nga CDC, Departamenti i Shëndetit Publik në Filadelfia, Departamenti i Edukimit në Pensilvani dhe është i informuar nga shumë organizata të tjera lokale, shtetërore dhe kombëtare të shëndetit dhe sigurisë. Dr. Barbara Klock do të udhëheqë përgjigjen tonë të shëndetit dhe sigurisë COVID-19 dhe do të kordinojë me administratorët dhe zyrtarët e shëndetit publik për vendimet që lidhen me shëndetin. Drejtoria do të marrë masa proaktive dhe të qëllimshme për të mbështetur shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë e të gjithë anëtarëve të komunitetit të tij. Kjo përfshin rishikimin, hulumtimin dhe rregullimin e kujdesshëm të rregullave, praktikave dhe sistemeve në fushat kryesore të mëposhtme:

## Distancimi Social

Distancimi social ka dy përbërës kryesorë:

1. mbajtja e individëve në një distancë të sigurt nga njëri-tjetri (6 feet) dhe
2. minimizimi i numrit të ndërveprimeve ballë për ballë.

Shembuj se si ne po planifikojmë ta zbatojmë këtë përfshijnë:

- Shënjat dhe sinjalet do të shënohen në dyshe me mure për të siguruar që studentët dhe punonjësit të mbeten gjashtë (feet) larg, kur presin të hyjnë në ndërtesë, duke qëndruar në rresht për të pritur ashensorë, duke ecur në korridore, etj.
- Përshtatjet do të bëhen në vendosjen e tavolinave kur është e nevojshme, për të lejuar për punonjësit për të mbajtur një distancë prej gjashtë feet.
- Madhësia e klasës me persona do të zvogëlohet dhe rregullimet në ulëse / tavolinat do të bëhen në mbështetje të praktikave sociale të distancimit kur është e mundur.

## Pajisjet Mbrojtëse Personale (PPE) dhe Protokollet e Higjenës

Drejtoria planifikon të shpërndajë pajisje mbrojtëse personale për studentët dhe punonjësit që t'i përdorin kur janë në ndërtesa. Këto pajisje përfshijnë një maskë, dezinfektant i duarve, termometrat dhe dorezat. U jepen udhëzime punonjësve në lidhje me PPE specifike të nevojshme bazuar në rolin dhe përgjegjësitë e tyre. E gjithë PPE do të blihet nga qendra dhe do të dërgohen para se studentët dhe punonjësit të fillojnë përsëri shkollën dhe punën.

Shembuj të protokolleve të sigurisë dhe higjenës përfshijnë:

- Të gjithë studentëve dhe punonjësve do t'u kërkohet të mbajnë një maskë që mbulon gojën dhe hundën në çdo kohë.
- Protokollet e përditshme të pastrimit do të vendosen për të siguruar që vendet e punës, pajisjet dhe objektet të jenë të pastra.
- Vendet e dezinfektimit të duarve do të caktohen në zona të zakonshme.



## Pyetësi i Hyrjes Ditore

Ne po planifikojmë që studentëve dhe punonjësve t'u kërkohet të plotësojnë një pyetësor të përditshëm për të vlerësuar nëse ata po përjetojnë simptoma ose janë të ekspozuar ndaj COVID-19. Rezultatet e pyetësorit do të përcaktojnë nëse individit duhet të shkojë në shkollë / punë ose të qëndrojë larg. Kryerja e kontrolleve të rregullta për simptoma dhe vetë-monitorimi i vazhdueshëm do të ndihmojë në uljen e ekspozimit.

## Rastet COVID-19 të dyshuar / konfirmuar

Ne do të ndjekim udhëzimet e Departamentit të Shëndetit Publik të Filadelfias (PDPH) në përgjigjen tonë për një diagnozë pozitive. Nëse marrim konfirmimin se një student ose një punonjës ka pasur një diagnozë pozitive COVID-19, do të ndërmerren veprime të menjëhershme duke kontaktuar menjëherë Departamentin e Shëndetit Publik të Filadelfias dhe duke ndjekur udhëzimet e tyre në lidhje me karantinën e mundshme (ose izolimin), identifikimin e personave të takuar, komunikimi me familjet dhe dezinfektimi i objekteve.

## Ndjekja e Kontaktit—transmetueshme

Zyra e Sëmundjeve Akute të Departamentit të Shëndetit në Filadelfia do të kryejë të gjithë përcjelljen e kontakteve.

## Kërkesat e imunizimit

Në këtë kohë, kërkesat e imunizimit të Departamentit të Shëndetit të Pensilvanisë për vitin shkollor 2020-2021 mbeten në fuqi.

## Trajnimi për Shëndetin dhe Sigurinë

Ne e pranojmë që "Ankthi i Kthimit" ekziston për shumë anëtarë të komunitetit tonë shkollor. Studentët, arsimtarët dhe personeli ndihmës të gjithë duhet të ndjehen të sigurt për të mësuar dhe punuar. Synimi ynë është të kenë një ndjenjë të sigurisë dhe besimit duke siguruar se ato kanë burimet e nevojshme për t'u rikthyer në punë dhe shkollë. Kjo do të thotë të ndërmarrësh hapa aktive për të zhvilluar dhe nisur trajnime dhe burime gjithëpërfshirëse në mënyrë që studentët dhe punonjësit të dinë se çfarë të presin kur të fillojnë shkollën dhe punën. Të gjithë studentëve dhe punonjësve do t'u kërkohet të marrin pjesë në trajnime virtuale për të mbështetur përdorimin e masave shëndetësore dhe të sigurisë. Trajnimi virtual do t'ju ofrohet gjithashtu prindërve / kujdestarëve përmes Akademisë Familjare.



## Modelet dhe Operacionet e Mësimit:

Fokusi i Zyrës së Shkollave është të ofrojë udhëzime me cilësi të lartë për të gjithë studentët në mjediset personale dhe dixhitale. Ne e pranojmë që ndërsa shumica e studentëve kanë qenë të angazhuar në mësim dixhital, studentët kanë qenë larg nga ato që dikur e njihnin si "shkollë", kështu që ne po përgatitemi për procedura që do të adresojnë nevojat sociale dhe akademike të studentëve. Ndërsa presim të rifillojmë përsëri në vjeshtë, ne po planifikojmë operacione që do të mbështesin tre modele të të mësuarit: Të mësuarit dixhital, të mësuarit hibrid dhe të mësuarit me persona/në klasa. Përmes këtyre tre modeleve të të mësuarit, ne do të jemi në gjendje të vazhdojmë drejt Mësimit në klasa ose të kthehemi drejt Mësimit dixhital sipas nevojës bazuar në kushtet aktuale shëndetësore dhe të dhënat në një kohë të caktuar. Këto modele përfshijnë:

FAZA E TANISHME  
DERI TEK QELLIMI  
PERFUNDIMTARE



### Mësimi dixhitalë

Mësuesit dhe studentët janë të angazhuar në udhëzime përmes një sistemi të menaxhimit të mësimit dhe një platforme virtuale të takimeve.



### Mësimi Hibrid

Një kombinim i të mësuarit në person dhe i mësimit në distancë.



### Të mësuarit me persona

Ndërveprimi që ndodh brenda dhe në kohë reale.

## Mësimi dixhital

Ne vazhdojmë të mësojmë se si të mbështesim më mirë studentët dhe punonjësit tanë në një mjedis mësimi dixhital, duke përfshirë punën me partneritete për të identifikuar dhe adresuar familjet që kanë nevojë për internet dhe të sigurojnë kosto të ulët për të mbështetur mësimin dixhital. Megjithëse synojmë të hapim dyert tona gjatë vjeshtës, ne e pranojmë se ekziston mundësia që mësimi dixhital të vazhdojë ose të prezantohet gjatë gjithë vitit.

## Mësimi Hybrid

Ndërsa ndërtesat fillojnë të rihapin dyert e tyre, një model hibrid është një metodë për të lehtësuar përsëri në udhëzimet e personave. Mësimdhënia me persona do të përqendrohet në temat që mësohen më mirë në klasë, ndërsa mësimi virtual do të përqendrohet në tema që mund të mësohen më mirë në internet.

## Mësimi me persona

Drejtorja njuh rëndësinë për t'u rikthyer në shkollë. Kthimi i të gjithë studentëve, mësuesve dhe punonjësve është qëllimi ynë.

Bazuar në udhëzimet aktuale të shëndetit publik, Drejtoria Arsimore është përqëndruar kryesisht në rifillimin e shkollave me një model të mësimit hibrid. Kjo do të kufizojë numrin e njerëzve fizikisht të pranishëm në një ndërtesë në çdo kohë për të akomoduar një distancë sociale. Ajo gjithashtu mbështet nevojën që disa studentë dhe të rritur të mësojnë/punojnë në distancë për shkak të kushteve ekzistuese ose shqetësimeve shëndetësore. Një model i të mësuarit hibrid mund të jetë i ndryshëm në të gjithë shkollat në varësi të madhësisë fizike të ndërtesës, numrit të studentëve të regjistruar, konfigurimit të klasës ose numrit të studentëve që duhet të kenë përparësi. Mendimet dhe reagimet do të informojnë programimin mësimor.

## Modeli i të mësuarit hibrid - Programet në konsideratë:

Brenda modelit të të mësuarit hibrid ne po eksplorojmë disa opsione se si mund të duket ky model i të mësuarit, përfshirë mundësinë e të pasurit një plan ndarje dhe fazës së studentëve dhe të punësuarve, siç përshkruhet më poshtë.

### Split Schedule

Çelësi:
Në persona(IP)      Mësimi në distancë (RL)

- **Programi AM/PM** - Studentët vijnë çdo ditë në shkollë, por me ndërrime / turne.

Studentë në Grupe	E Hënë		E Martë		E Mërkurë		E Enjte		E Premte	
	AM (mëngjes)	PM (mbasdite)	AM (mëngjes)	PM (mbasdite)	AM (mëngjes)	PM (mbasdite)	AM (mëngjes)	PM (mbasdite)	AM (mëngjes)	PM (mbasdite)
Grupi A	RL	IP	RL	IP	RL	IP	RL	IP	RL	IP
Grupi B	IP	RL	IP	RL	IP	RL	IP	RL	IP	RL

- **Programi Dita A/ Dita e B** - Studentët vijnë në ndërtesën e shkollës në ditë alternative me ndërrime / turne

Studentë në Grupe	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
Grupi A	IP	RL	IP	RL	IP
Grupi B	RL	IP	RL	IP	RL

- **Programi i Javës A/ Java B** - Studentët vijnë në ndërtesën e shkollës në javë të ndryshme me ndërrime / turne.

Studentë në Grupe	Java 1					Java 2				
	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte	E Hënë	E Martë	E Mërkurë	E Enjte	E Premte
Grupi A	IP	IP	IP	IP	IP	RL	RL	RL	RL	RL
Grupi B	RL	RL	RL	RL	RL	IP	IP	IP	IP	IP

Përveç orareve të ndara, Drejtoria po shikon fazat që studentët dhe punonjësit të kthehen në ndërtesa.

### Faza In

Disa studentë vijnë të parët fizikisht në klasa, në shkollë, ndërsa studentë të tjerë vazhdojnë mësimin dixhital. Për shembull, që nga P - K deri në klasat e treta nxënësit të fillojnë shkollën të parët, ndërsa nxënësit e shkollave të mesme vazhdojnë mësimin dixhital derisa udhëzimet e distancës sociale të qetësohen.


Në grupimin e studentëve së bashku për qëllime të programit, Drejtoria aktualisht është duke eksploruar një grup model ku të njëjtët studentë janë së bashku në masën më të gjatë të mundshme për të kufizuar numrin e ndërveprimeve. Drejtoria aktualisht po planifikon të përcaktojë me përparësi grupet e mëposhtme për të mësuarit me persona, pasi ata përjetojnë vështirësitë më të mëdha në një mjedis të të mësuarit dixhital;

- Studentë me Nevoja Komplekse, të tilla si Autistic Support Autizmi, Occupation / Therapy, Nxënës që kanë vështirësi në dëgjim
- Studentë të porsaardhur për të cilët Anglishtja është gjuha e dytë, Niveli 1 dhe Niveli 2
- Parashkollor deri në Klasat e 6ta

## Operacionet

Ndërsa mendojmë për funksionimin e përditshëm të shkollës në të gjitha nivelet, qëllimi ynë është bazuar në mirëqenien e studentëve dhe sigurinë me një nivel të lartë kujdesi. Drejtoria arsimore mund të rishikojë kalendarin shkollor 2020-2021 për të siguruar që ka kohë të mjaftueshme për të trajnuar punonjësit dhe për të provuar proceset e "hapjes së shkollës", të cilat përputhen me shëndetin, dhe nevojat e sigurisë të studentëve dhe të punonjesve. Pasi të fillojë viti shkollor po merret në konsideratë një periudhë kalimtare që i kushton më pak theks akademikëve për të adresuar nevojat emocionale sociale të studentëve dhe të rriturve.

Drejtoria shikon operacionet ditore të shkollës duke parë 1) *shkollën*, 2) *hyrjen në shkollë*, 3) *të qenit brenda shkollës*, dhe 4) *largimi nga shkolla*.







## Shkuarja në Shkollë

Ne e kuptojmë dhe po planifikojmë që studentët të arrijnë në shkollë në mënyra të shumta, dhe se ardhja ndryshon në varësi të rregullave të transportit të Drejtorisë. Sapo studentët të largohen nga shtëpitë e tyre, është që ata të arrijnë në shkollë të sigurt dhe të gatshëm për të mësuar.

Zyra e Transportit po propozon plane dhe protokolle të qarta dhe të përcaktuara për studentët që marrin transport, duke përfshirë një propozim të orarit të autobuzëve me tre nivele që fillon në 7:20 të mëngjesit, 8:20 të mëngjesit, 9:20 të mëngjesit.


Orari i autobuzëve me tre nivele do të mbajë orët e kërkuara të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë dhe do t'i përmbahet udhëzimeve të shëndetit dhe sigurisë dhe distancës sociale me afërsisht 33 studentë për automjet. Plani i sigurisë do të përfshijë sedilen e caktuar (një fëmijë për sedile ose dy fëmijë nëse jetojnë në të njëjtën shtëpi) dhe planet e rishikuara në lidhje me numrin e nxënësve. Nëse miratohet, orari i autobuzëve me tre nivele do të përputhet me modelet e propozuara të mësimdhënies dhe do të ndikojë në kohën e fillimit dhe mbarimit të shkollës.

Përveç kësaj ne presim që mund të ketë një rritje në familjet që marrin fëmijën e tyre nga shkolla. Si rezultat ne do të krijojmë plane për një numër më të madh të makinave në zonat rreth shkollave. Zyra e Transportit do të sigurojë trajnime për punonjësit e saj në udhëzimet e sigurisë, PPE, ngarkesat dhe procedurat e shkarkimit.



## Hyrja në Shkollë

Shkollat do të duhet të përgatiten për hyrjet dhe daljet nga korridoret, hyrjet dhe daljet nga ndërtesat e shkollave, të përqëndrohet në masat e sigurisë për studentët dhe punonjësit, pasi individët hyjnë dhe kalojnë nëpër ndërtesë. Studentët dhe punonjësit do të duhet të praktikojnë distancën sociale dhe të mbeten 6 feet larg në masën maksimale të mundshme. Planet aktuale përfshijnë shënimin e dyshemesë me shirit të lëvizshëm për të përcaktuar një qarkullim të njëanshëm të trafikut dhe identifikimin e distancave prej 6 feet për studentët që presin të hyjnë në ndërtesë.





## Duke qenë brenda shkollës

Para hapjes së shkollës, shkollat do të plotësojnë hartat individuale shkollore për të ekzaminuar nga afër infrastrukturën e objektit të tyre. Shkollat do të mendojnë për masat e sigurisë për zyrat e përparme, korridoret, sallat e drekave, monitorimin e banjove dhe pjesëve të tjera të shkollës për të minimizuar numrin e nxënësve dhe të punësuarve në këto zona në çdo kohë të caktuar.

Planet e dyshemesë në klasë do të rishikohen për të maksimizuar distancën midis studentëve gjatë mësimi ballë për ballë, duke përfshirë studentët që përballen me të njëjtin drejtim sesa studentët përballë njëri-tjetrit dhe tavolinat e studentëve janë 6 feet larg në maksimumin e mundshëm.

Drejtuesit e shkollave do të konsiderojnë përdorimin e kafeterive, ambienteve të fiskulturës, bibliotekave dhe hapësirave të tjera më të mëdha se hapësira e klasës për të ndihmuar në minimizimin e numrit të nxënësve në klasa. Konsideratat shtesë përfshijnë përdorimin e ndarësve për të ndarë klasat brenda hapësirave më të mëdha.

Drejtorja po konsideron gjithashtu ndërprerje dhe përdorimin e hapësirave të jashtme në procesin e planifikimit. Kjo mund të përfshijë oraret e modifikuar të ndërprerjes dhe përfshirjen e aktiviteteve në distancë sociale të cilat promovojnë ushtrime fizike por nuk lejojnë pajisje të përbashkëta.

Pavarësisht modelit ose orarit mësimor, të gjithë studentët do të marrin mëngjes dhe drekë. Për studentët që hyjnë në shkollë në mëngjes, mendimi ynë aktual është që studentëve do t'u ofrohet një mëngjes i shpejtë në derë, i cili më pas do të hahet në klasë. Për studentët në shkollë gjatë drekës, studentët do të distancohen në rrjesht për të marrë drekën dhe mund të hanë në kafeterinë duke respektuar distancën sociale ose do të hanë në klasën e tyre. Studentët e angazhuar në mësimin dixhital mund të marrin një kuti me ushqimin e mëngjesit dhe drekës për ta ngrënë në shtëpi.

Për shkak të udhëzimeve për shëndetin, sigurinë dhe protokollet COVID-19, ne kuptojmë se ndryshimet në procedurat e vaktit të ushqimit do të kërkojnë pastrim shtesë të tavolinave, mbledhjen e plehrave në të gjithë shkollën dhe më shumë punonjës për të mbështetur modelin.



## Largimi nga Shkolla

Shkollave do të duhet të marrë në konsideratë kohërat e shkëputura të largimit nga puna për të promovuar distancimin shoqëror dhe menaxhimin e autobuzëve shkollore, marrjen e makinave, ofruesit e kohës jashtë shkollës, programet atletike dhe programe shtesë kurrikulare në përputhje me kërkesat e Departamentit të Shëndetit të Filadelfias.

Në përgjithësi, operacionet ditore do të drejtohen nga udhëzimet e shëndetit dhe të sigurisë, të përshkruara nga CDC, Departamenti i Edukimit i PA, Departamenti i Shëndetit Publik i Filadelfias dhe mjekët dhe ekspertët e shëndetit publik nga Spitali i Fëmijëve në Filadelfia me kontribut nga palët e interesuara.

## Prioritizimi i mirëqenies emocionale sociale të studentëve

Ne e dimë se rifillimi në shkollë pas shumë muajsh do të kërkojë kohë për të adresuar nevojat emocionale sociale të studentëve. Ne po shqyrtojmë të propozojmë kohë shtesë para se të fillojë shkolla për t'u lejuar mësuesve dhe personelit kohë për tu rikthyer dhe të ofrojnë trajnime në mënyrë që ata të identifikojnë shenjat e traumës dhe të identifikojnë studentët që kanë nevojë për mbështetje.

# Konsideratat e fuqisë punëtore

Drejtoria është përkushtuar të sigurojë që punonjësit tanë të ndjehen të sigurt dhe të mbështetur gjatë kësaj kohe të vështirë dhe të kenë akses në pritje dhe komunikime të qarta dhe të qëndrueshme. Si i tillë, plani i rihapjes përfshin përbërës të ndryshëm që lidhen me katër fusha kryesore, secila e udhëhequr nga Departamenti i Shëndetit Publik i Filadefias dhe CDC: 1) politika dhe procedura, 2) trainim dhe mbështetje, 3) nevoja për personel dhe 4) Shëndeti i punonjësve.

## Politikat dhe Proçedurat

Koha e pashembullt kërkojnë mënyra të reja të punës dhe përgjegjësi dhe si të tilla ne po shqyrtojmë, rishikojmë dhe shtojmë rregulla dhe proçedura të reja. Kjo përfshin:

### Udhëzimet e shëndetit dhe sigurisë

- Shëndeti dhe Sigurisa vijnë së pari - këto protokolle do të zbatohen për të bërë gjithçka që është e mundur për të siguruar që të gjithë janë të sigurtë.

### Rregullat e pjesëmarrjes, pushimit dhe akomodimit

- Kjo përfshin azhurnimin e rregullave ekzistuese për të siguruar që ka fleksibilitet dhe mbështetje për punonjësit përmes secilit model mësimi.

### Protokollet e Vlerësimit

- Drejtorja duhet të sigurojë që mësuesit të marrin mendime/reagime të vazhdueshme në çdo model të të mësuarit që është në përputhje me ligjin shtetëror dhe mbështetës të modeleve të ndryshme të të mësuarit.

### Rregullat e punës nga shtëpia

- Ne jemi duke eksploruar modele fleksibël të punës për t'i lejuar punonjësit të ruajnë produktivitetin dhe shërbimin ndaj studentëve, pavarësisht nga faza e ri-hyrjes në vendin e punës.

## Trajnim dhe mbështetje

Drejtorja duhet të përgatisë punonjësit për mënyrat e reja të mësimdhënies dhe po planifikon ta bëjë këtë përmes trajnimit dixhital. Këto trajnime përfshijnë Drejtimin dhe Mësimdhënien në një Model të Ri, Shëndetin dhe Sigurinë, dhe të tjera sipas nevojës.







## Personeli

Celësi për të gjithë punën që bëjmë në shërbim të studentëve dhe familjeve janë punonjësit tanë të jashtëzakonshëm. Ajo që punonjësit tanë kanë qenë në gjendje të arrijnë gjatë kësaj kohe të provuar ka qenë heroike. Për këtë qëllim plani i rifillimit duhet të sigurojë që:

### Ekziston një plan i qartë për të rikthyer punonjësit.

- Drejtoria po eksploron një mënyrë të rregulluar me qëllim që të rritet ngadalë numri i të punësuarve që kthehen në ndërtesa, duke filluar me punonjësit kryesore dhe duke vazhduar fazat e tjera për të gjithë punonjësit.

### Ekziston një personel i mjaftueshëm për të realizuar punën në fjalë.

- Ne kemi lëshuar një anketë për të kuptuar gatishmërinë e punonjësve për t'u kthyer. Të gjithë kanë rrethana unike dhe ne do t'i përdorim rezultatet e kësaj ankete për të projektuar modele për personelin dhe nevojën për punonjës shtesë.

### Ndryshimet e orarit të punës janë eksploruar për të mbështetur një mënyrë të re të punës.

- Drejtoria do të sigurojë orare fleksibël të punës për të mbështetur distancimin shoqëror.

## Shëndeti i punonjësve

Drejtoria pranon nevojën për të qenë fleksibël dhe mbështetës të nevojave unike të punonjësve gjatë kësaj kohe. Ne e pranojmë që nuk mund të bëjmë atë që duhet për studentët që u shërbejmë nëse nuk kujdesemi për vehten tonë. Ne jemi duke punuar për të siguruar që punonjësit janë të mbështetur dhe të kenë mundësi në burime të ndryshme për të adresuar nevojat e tyre për shëndetin mendor përmes "District's Employee Assistance Program". Përveç rregullave të qarta dhe përfitimeve ekzistuese, Drejtoria po u siguron të gjithë punonjësve një abonim 1-vjeçar në aktivitete dhe këshilla dixhitale të Shëndetit.

# Afati kohor

Qëllimi ynë është të ndajmë një plan përfundimtar që pasqyron kontributin e palëve të interesuara në Korrik në mënyrë që Drejtoria jonë dhe familjet tona të mund të përgatiten për një vit shkollor të suksesshëm dhe të sigurt 2020-2021.

- Seancat virtuale dhe anketimi i palëve të interesuara
- Udhëzimet e CDC për rihapjen e shkollave
- Departamenti i Shëndetësisë së Filadelfias, rishikimi i të gjitha procedurave dhe ipraktikave për rifillimin e mësimdhënies
- Zbatimi i planit për të rifilluar mësimdhënien dhe të mësuarit Kualifikim profesional për të gjithë personelin
- Shpërndarja e furnizimit të shkollave
- Anketimi i dytë i palëve të interesuara në lidhje me mendimet e tyre përpara hapjes së shkollave
- Anketimi i tretë i palëve të interesuara për të përcaktuar nivelin e kënaqshëm në përpjekjet e hapjes së shkollës
- Plani i PA për rihapjen e shkollave
- Plani i rihapjes për qytetin e Filadelfias
- Rihapja paraprake Tabela e strukturave

